



Plani i Biznesit

K.R.U “Hidroregjioni Jugor” Sh.A.
Prizren

2011 – 2014



K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A
RR. WESLEY CLARK P.N
20000 PRIZREN

Tel/ Fax : 029/ 244 150
E-Mail: sh.a-hidroregjionijugor-prizren@hotmail.com
www.hr-juqor.com

1	Përmbledhje e përgjithshme	3
1.1.1	Historiku I Kompanisë	3
1.1.2	Deklerata e politikës	3
1.1.3	Deklerata e „misionit“	4
1.1.4	Analiza SWOT	4
1.1.5	Tarifat e shërbimit	5
1.1.6	Qëllimet dhe objektivat strategjike	7
1.1.7	Objektivat kryesore të kompanisë	7
1.1.8	Performancat deri më sot	7
2	Shërbimet për Konsumatorë	8
2.1	Parashikimi i Kërkesës dhe parashikimi i matjes	10
2.1.1	Parashikimi i Kërkesës për ujë	10
2.1.2	Gatishmëria për të paguar	11
2.1.3	Trendet e kërkesave më të shpështa të konsumatorëve	11
2.1.4	Kërkesat e performancës së shërbimit ndaj Konsumatorëve	11
2.1.5	Rregullimi/Konvertimi I lidhjeve të paligjshme bazuar në ligjin	12
2.1.6	Ndryshimet e mundshme në zonat operacionale	12
3	Plani Operacional	12
3.1.1	Planifikimi I zgjerimit të shërbimeve	13
3.1.2	Plani I investimeve Kapitale	14
3.1.3	Infrastruktura e re	14
3.1.4	Përritja e infrastrukturës	15
3.1.5	Investimet Kapitale jo-infrastrukturore	15
3.1.6	Objektivat kryesore të Shërbimit Teknik	17
3.1.7	Planifikimi i humbjeve të ujit	18
3.2.1	Plani operacional	19
4	Plani I menaxhimit të aseteve	20
5	Plani Financiar	20
5.1.1	Masat e planifikuara për arritjen e objektivave	22
5.1.2	Analiza e shpenzimeve	23
6	Plani I zhvillimit të stafit	24
6.1.1	Trajnimi i stafit	25
6.1.2	Struktura organizative	25

Shtesa: Forma tabelare për të gjitha shërbimet

1. PERMBLEDHJA E PERGJITHSHME

1.1.1 Historiku i Kompanise

Në vitin 1962 ka filluar të ushtrrojë veprimtarinë e saj si ndermarrje Shoqerore e njohur me emrin “Cvileni”, që nga viti 1999 ka funksionuar si Ndermarrje Publike nën DSHP shtylla e IV e UNMIK-ut, ndërsa që nga mesi i vitit 2003 kjo Kompani është regjionalizuar me 4 njësi në vete: Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë.

Që nga Korriku i vitit 2007 funksionon si Shoqëri Aksionare K.R.U. “Hidroregjioni Jugor” SH.A.

Kompania e ujësjellesit rajonal Hidroregjioni Jugor, shërbimet e veta i ofron në pjesën jugore të Kosovës duke përfshirë këto komuna:

- Prizrenin
- Suharekën
- Dragashin
- Malishevën

Rrjeti furnizues që i kryen shërbimet përfshinë 4 njësi operacionale: Njësinë Prizren, Suharekë, Dragash dhe Malishevë. Furnizimi me ujë bëhet prej burimeve vetanake. Në nivel të Kompanisë furnizohen edhe 22 fshatra që janë të kyçur në rrjetin e Kompanisë Regjionale Prizren, Suharekë, Malishevë. Numri i popullatës në të cilën Kompania e Ujësjesit Regjional Prizren i kryen shërbimet e veta vlerësohet të jetë rreth 200.000 banorë.

Kapaciteti momental prodhues sillët rreth 850 l/sec., deponimet e ujit 10.000 m³, rrjeti distributiv $\Phi 50$ - $\Phi 600$ L=224 km, rrjeti i kanalizimit $\Phi 200$ - $\Phi 1500$ L=151 km. Qytetit furnizohet 60% me pompa, 40% me gravitet. Stacionet e pompave janë në Njësinë e Prizrenit: Bunari I, Bunari II, Sozi-Nashec, Vermicë, Konjush I, Konjush II, në njësinë e Suharekës burimi Pusi i atit, Savrova, Topallnica dhe Fidanishte, në njësinë e Dragashit burimi Radesha, në njësinë e Malishevës burimi Banjë.

Në Kompani ekzistojnë 23 njësi matëse të energjisë elektrike me kapacitet P= 50 deri 630 KVA.

Kompania Regjionale Prizren ka një fabrikë për trajtimin e ujit në Njësinë e Prizrenit me kapacitet 150 l/sec.

1.1.2 Deklarata e politikës

Menagjmenti i KUR “Hidroregjioni Jugor” SH.A. i përkrahur nga palët e interesit (Bordi i Drejtorëve, aksionarët, konsumatorët etj) dhe me ndihmën e të gjithë punëmarrësve kanë

për qëllim furnizimin me ujë pa ndërprerë të të gjithë konsumatorëve në zonën e shërbimit.

Të vetëdijshëm se në kushtet e tanishme kjo është një gjë e pamundur do të vihen në dispozicion të gjitha burimet njerezore dhe burimet financiare që të minimizohen humbjet teknike dhe zhduken në tërësi humbjet administrative të ujit nga njëra anë dhe të maksimalizohen të gjitha aktivitetet lidhur me rritjen e shkallës së arkëtimit.

Prandaj është një prioritet i përcaktuar zvogëlimi i sasisë së ujit pa të ardhura dhe pagesa për shërbimet.

Përmes këtyre aktiviteteve në të ardhmen do të krijohen kushte të favorshme për rritjen e nivelit të investimeve nga burimet vetanake.

Përmbushja e një vizioni të tillë do të krijonte parakushte më të mira për investime nga donatorët dhe agjensionet tjera financiare.

1.1.3 Deklarata e “misionit”

Misioni i KUR “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. është: furnizimi me ujë të pijshëm, largimi i ujërave të ndotura, mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm si dhe mirëmbajtja e rrjetit të ujërave të ndotura.

Orientimi i aktiviteteve të punës do ta ketë konsumatorin në qendër të vëmendjes. Të gjithë konsumatorët do të kenë trajtim dhe çasje në shërbim: pa diskriminim racor, pa diskriminim në përkatësinë religjioze, pa diskriminim në përkatësinë kombëtare, pa diskriminim në përkatësinë gjinore.

Duke përmbushur këtë “mision” do të bëhet i mundur sigurimi i një aktiviteti të vetëfinancueshëm me qëllimin e fundit që të sigurojmë shërbime cilësore të ujit të pijshëm në pajtim me standardet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Çasja e afarizmit të kompanisë do të jetë transparente dhe e bazuar në dispozitat ligjore. Kjo do të bëhet në bashkëpunim me palët e interesit:

- Punëmarrësit,
- Aksionarët-Bordin e Drejtorëve - Qeveria
- Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor,
- Ministrinë për Ekonomi dhe Financa,
- Zyrën Rregullative për Ujë dhe Mbeturina
- Konsumatorët (të organizuar në komisione, shoqata etj).

1.1.4 Analiza - SWOT

Përgaditjes së këtij Plani të Biznesit i është çasur nga parimi i vazhdueshmërisë dhe zhvillimi i aktiviteteve biznesore në një periudhë të gjatë kohore. Rreziqet e mundshme

në aspektin e parashikimit për periudhën në të cilën bëhet ky Plan i Biznesit dhe pamundësia e realizimit të tij mund të përmbliidhen në:

Përparësitë:

- Përmirësimi i shërbimeve për konsumatorë
- Partnerët strategjikë (SHUKOS, ZRRUM, Komunat, Qeveria etj.)
- Tradita (Përvoja)
- Të tjera

Mundësitë, shanset:

- Përmirësimi i infrastrukturës
- Investimet nga Donatorët (Investimet nga KfË dhe USAID-i etj.)
- Bashkëpunimi me kompanitë tjera
- Veprimi i shtetit ligjor (Procedimi dhe dënimi i keqpërdoruesëve etj.)
- Rritja e mirëqenies sociale (investimet, zvogëlimi i papunësisë etj.)
- Të tjera

Dobësitë

- Konfliktet e brendshme midis të punësuarëve
- Motivimi i dobët
- Shkathtësitë e pamjaftueshme (mungesa e personelit profesional etj.)
- Të tjera

Kërcënimet, rreziqet:

- Kriza ekonomike
- Tensionet sociale e politike
- Fatkeqësitë natyrore,(vërshimet, tërmetet, mungesa e ujit në burime etj.)
- Të tjera

1.1.5 Tarifat e shërbimit

Kompania KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. do të zbatojë tarifën e çmimeve që do ta vendosë Zyra Rregullative për Ujë dhe Mbeturina konform Ligjit N 03/L-086 si autoritet i vetëm dhe kompetent për përcaktimin e tarifave. Në bazë të kësaj Rregulloreje është përcaktuar “mbulimi i të gjitha kostove të operimit dhe investimeve”

Tarifat e miratuara nga ZRRUM-in do të jenë ekskluzivisht në funksion të mbulimit të shpenzimeve operative, rritjes së investimeve kapitale dhe përpjekjes për bashkëfinancimin e shumë projekteve të mundshme kapitale me komunitetin, me komunat përkatëse dhe me donatorët. Rritjet e reja do të ndikojnë pozitivisht dhe do të mobilizojnë menagjmentin dhe personelin tjetër në KUR “Hidroregjioni Jugor” SH.A. në përmbushjen me sukses të misionit të përcaktuar.

Tarifat e reja do të kenë efekt në stimulimin e kursimit të ujit në dobi të konsumatorit nga njëra anë (direkt) dhe nga ana tjetër do të ketë përfitime indirekte përmes kthimit të të njejtës në shërbime më të mira. Tarifat janë të miratura vetem për vitin 2011.

TARIFAT PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAT TË ZEZA 2010

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/m ³)	Tarifa volumetrike të ujërave të zeza (Eurom ³)
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.24	0.04
Konsumatori Komercial/Industrial	3.0	0.51	0.08
Konsumatori institucional	3.0	0.51	0.08

TARIFAT PËR SHËRBIMET E UJIT DHE UJËRAT TË ZEZA

2011

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/m ³)	Tarifa volumetrike të ujërave të zeza (Eurom ³)
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.27	0.04
Konsumatori Komercial/Industrial	3.0	0.57	0.08
Konsumatori institucional	3.0	0.57	0.08

2012

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/m ³)	Tarifa volumetrike të ujërave të zeza (Eurom ³)
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.27	0.04
Konsumatori Komercial/Industrial	3.0	0.57	0.08
Konsumatori institucional	3.0	0.57	0.08

2013

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/m ³)	Tarifa volumetrike të ujërave të zeza (Eurom ³)
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.27	0.04
Konsumatori Komercial/Industrial	3.0	0.57	0.08
Konsumatori institucional	3.0	0.57	0.08

2014

Kategoria e konsumatorit	Tarifa fikse (Euro/muaj)	Tarifa volumetrike për ujë të pijes (Euro/m ³)	Tarifa volumetrike të ujërave të zeza (Eurom ³)
Konsumatori Shtëpiak	1.0	0.27	0.04
Konsumatori Komercial/Industrial	3.0	0.57	0.08
Konsumatori institucional	3.0	0.57	0.08

1.1.6 Qellimet dhe objektivat strategjike

Si qellime kryesore të KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A. jane:

- Kontinuiteti i vazhdueshëm i prodhimit te ujit të pijshëm,
- Kontrolla e kualitetit të ujit të pijshëm të jetë në pajtim me instruksionet e lëshuara ngarregullorret në fuqi.
- Rritja e shkallës se inkasimit si dhe zvogëlimi i ujit të pafaturuar
- Rritja e shkallës së efikasitetit të punëtorëve.


1.1.7 Objektivat kryesore të KRU “Hidroregjioni Jugor” Sh.A

- Mirëmbajtja e stabilimenteve Elektro-makinerike,
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit të pijshëm dhe ujërave të zeza me qëllim të zvogëlimit të humbjeve në rrjet dhe evitim të prishjeve me kohë,
- Aktivitetet në përfundimin e projekteve për instalimin e ujëmatësave,
- Përpjekjet që çdo konsumatori ti matet sasia e ujit të shpenzuar dhe ti bëhet faturimi në bazë të sasisë së ujit të shpenzuar,
- Pasurimi i Sistemit Gjeografik të Informimit me të dhena të reja,
- Përpjekjet maksimale në identifikimin e klientëve të rinj,
- Angazhimi në mbledhjen e borgjeve të vjetëra si dhe inkasimi i faturave rrjedhëse,
- Identifikimi dhe rritja e numrit te konsumatorëve përfshirë këtu edhe lidhjet ilegale,
- Vazhdimi i informimit të konsumatorëve dhe bashkëpunimi me organet komunale ne mënyrë që shfrytëzimi i ujit të bëhet në suaza normale,
- Trajnimi i kuadrove në fusha të ndryshme si: në teknologjitë bashkekohore të trajtimit të ujerave të pijshëm dhe ujërave të zeza, në fushën e ekonomisë, financave, etj.

1.1.8 Performanca der më sot


Inkasimi 2008 – 2009 – 2010

INKASIMI	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QER.	KORRIK.	GUSHT	SHTA.	TET.	NENT.	DHJET.	TOTAL
2008	133,656	116,409	166,463	124,430	150,764	115,654	156,155	127,343	136,084	158,691	125,567	125,567	1,636,783
2009	130,428	115,854	112,946	162,541	124,494	128,283	156,594	132,281	142,077	167,116	147,277	147,277	1,667,168
2010	111,041	165,870	144,256	137,121	138,222	134,557	143,384	206,064	166,152	211,488	211,497	211,497	1,981,149



SHPENZIMET 2008 – 2009 - 2010

	JANAR	SHKURT	MARS	PRILL	MAJ	QER.	KORRIK.	GUSHT	SHTA.	TET.	NENT.	DHJET.	TOTAL
2008	143,318	135,684	229,385	175,507	134,301	139,426	142,613	131,754	143,505	143,891	150,480	177,143	1,847,007
2009	144,896	154,762	159,951	142,562	118,489	165,498	152,698	149,856	153,981	154,480	184,978	181,945	1,864,096
2010	163,940	150,869	171,257	147,127	126,309	131,769	195,128	159,038	184,333	210,117	194,007	194,007	2,027,901




2. Shërbimet per Konsumatore

Departamenti për Shërbime të Konsumatorit (SHK) bënë organizimin e shërbimeve dhe marrëdhëniet me konsumatorët. Siguron performancë të mirë të shërbimeve për konsumatorët, siguron komunikimin me të gjitha departamentet tjera, ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme që të ngrisë shkallen e inkasimit. Urdhëron ndërprerjen e furnizimit me ujë për shkelësit e kontratës dhe monitoron ekzekutimin e urdhrat. Organizon punën

e ekipeve të kontrollës dhe ç'kyçjes, pranon raportet e tyre dhe ndërmerr veprime të menjëhershme dhe urgjente. Pranon kërkesat për kyçe të reja, përgatitë dokumentacionin dhe i dorëzon ato në departamentin për kompletimin e procedurave.

Gjatë vitit 2011 ky shërbim do të angazhohet në nxjerrjen, ndryshimin dhe implementimin e plotë të të gjitha procedurave dhe rregulloreve në pajtim Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike dhe me standardet e ZRRUM-it,.

FORMA SKEMATIKE E PROCEDIMIT TË ANKESAVE DHE KËRKESAVE TË KONSUMATORËVE




2.1 Parashikimi i kërkesës dhe parashikimet e matjes

2.1.1 Parashikimi I kërkesës për ujë

Gjatë vitit 2010 janë faturuar rreth 7 milion m³. Kompania në politiken zhvillimore ka në plan edhe zgjerimin e shërbimeve edhe në pjeset tjera të fshatrave të cilat janë jashtë menagjimit të kompanisë. Ne në planifikimet tona parashofim që edhe fshatrat që janë jashtë menagjimit të Kompanisë në të ardhmen të jenë nën menagjimin tonë. Kuvendet Komunale për të gjitha fshatrat ku kanë investuar janë të interesuara të jenë nën menagjimin e Kompanisë "Hidroregjioni Jugor". Ne jemi në fazën e analizave të të gjitha kërkesave të ofruara për menagjim. Ne disponojme me stafin dhe mekanizmin për të bërë një shërbim cilësor dhe efektiv krahasuar me gjendjen çfare e disponojnë me vetë menagjim. Parashohim që gjatë vitit 2011 të kemi rritje prej 3070 konsumatorëve si rezultat i marrjes në menaxhim të sistemeve të ujësjellsit në fshatra ku ne total vjetor planifikohet të faturohet rreth 400 000 m³ ujë, që në total do të faturohet 7.400.000 m³ ujë. (5-6% faturim me shume).

Nr. I Konsumatorëve 2010 – 2014

Planifikimi 2011-2014	2010	2011	2012	2013	2014
Nr. Total I konsumatorëve	32,979	36,195	38,420	38,936	39,178



Gatishmëria për të paguar

Përveq inkasimit derë më derë, konsumatorëve do të ju ofrohet mundësia e pagesës së faturës së shërbimeve të ujit në të gjitha bankat komerciale si dhe sportelet në lokalet e kompanisë. Për borxhet e akumuluar të konsumatorëve do të ofrohet riprogramimi i borxhit si dhe pagesa e tij në kiste mujore.

2.1.3 Trendet e kërkesave më të shpeshta të konsumatorëve

Një ndër objektivat kryesore e kompanisë për vitin 2011 deri në vitin 2014 është rritja e të hyrave, respektivisht rritja e inkasimit nëpërmjet faturimit të matur të konsumatorëve. Kompania është e orientuar që të jetë financiarisht e vetëqëndrueshme dhe e aftë të kryej të gjitha shërbimet e domosdoshme.

Në këtë drejtim janë paraparë masa konkrete të cilat do të rezultojnë në rritjen e inkasimit;

- Perpilimi dhe implementimi i kodit të miresjelljes së stafit të KRU “Hidroregjioni Jugor” ndaj konsumatorëve
- Ndërimi i tereneve të inksantëve për evitim të familjarizimit me konsumator
- Trajnimi i stafit , me qëllim të përmirësimit të sjelljeve dhe kontakteve me konsumatorë
- Funkcionalizimi i Zyrës Pritëse për Konsumatorë
- Shqyrtimi i drejtë, i paanshëm dhe në afat sa më të shpejtë i të gjitha ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve
- Leximi i rregullt dhe i saktë i ujëmatësve duke i penalizuar inkasantët për moslexim
- Faturimi sipas shpenzimit (Eliminimi i faturimit paushall)
- Marrja e masave ligjore sipas Zyrës Rregullative (procedurat e shkyçjes)
- Forcimi i ekipeve të kontrolles dhe ekipeve për shkyçje
- Zgjidhja e rasteve sociale në bashkëpunim me institucionet tjera relevante

Kompania do të angazhohet dhe shpreson që gjatë vitit 2011 të inkasojë edhe borxhet e ndërmarrjeve të privatizuara.

2.1.4 Kërkesat e performancës së shërbimit ndaj konsumatorëve

Nëpërmes funksionalizimit të Zyrës Pritëse për konsumator, konsumatori do ta ketë personin a parë kontaktues për ankesën dhe kërkesën që ka, gjithashtu kjo zyre dotë ketë numrit të telefonit që do të jetë në dispozicion 12 orë për konsumatorin ku do të lajmëroj të gjitha ankesat dhe kërkesat e tij .Komisioni për Shqyrtimin e Ankesave të Konsumatorëve do të administrojë të gjitha ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve dhe në një afat sa më të shkurtër do të shqyrtojë ato dhe do të përgjigjet konsumatorëve.

Me qëllim të zbatimit dhe shqyrtimit të ankesave të konsumatorëve do të plotësohen dhe të organizohen trajnime të stafit të shërbimit me konsumatorë.

Me përmirësimin e shërbimeve ndaj konsumatorëve kompania planifikon që të arrijë edhe përmirësimin e performancave sidomos në rritjen e numrit të konsumatorëve, pasivizimin e konsumatorëve fiktiv, rritjen e sasisë së faturimit, zvogëlimin e keqpërdorimeve, zvogëlimin e lidhjeve ilegale, dhe përmirësimin e inkasimit që është një ndër objektivat kryesore dhe të domosdoshme të kompanisë.

2.1.5 Rregullimi/konvertimi i lidhjeve te paligjshme. Bazuar ne ligjin

Të gjitha lidhjet e paligjshme të cilat do të zbulohen nga ekipi I kontrollës do të legalizohen në pajtim me rregulloret e ZRRUM-it, duke paguar taksat dhe shpenzimet e nevojshme.

2.1.6 Ndryshimet e mundshme ne zonat operacionale

- **Ne njesine e Prizrenit** planifikohet qe ne te ardhmen te jenë ne kuader të sherbimeve tona keto fshatra: Velezha, Shpenadi, Smaqi, Caparci dhe Trepetnica .Me inkuadrimit e ketyre fshatrave do te rritet numri i konsumatoreve per 1360 konsumatore.
- **Ne njesine e Suharekes** planifikohet qe të inkuadrohen këto fshatra: Ternje, Mushtishti dhe Sallagrazhë.Me inkuadrimit e ketyre fshatrave do te rritet numri i konsumatoreve per 990 konsumatore.
- **Ne njesine e Malisheves** planifikohet qe te inkuadrohen keto fshatra: Gurbardhi, Turjaka dhe Dragobili.Me inkuadrimit e ketyre fshatrave do te rritet numri i konsumatoreve per 473 konsumatore.
- **Ne njesine e Dragashit** planifikohet qe te inkuadrohet fshati: Rrapqe e lartë. Me inkuadrimit e këtij fshati do te rritet numri i konsumatoreve per 230 konsumatore.

3. Plani Operacional

Programet Operacionale teknike ne rrjetin e ujit te pijes, kanalizimit dhe stabilimenteve Elktro-mekanike në vitin 2011 do te koncentrohet në këto kerkesa :

Furnizimi i rregullt me ujë , kualitetin e ujit , mirëmbajtjen e rregullt të rrjetit të ujit dhe kanalizimit , zvoglimin e humbjeve teknike, zgjerimin e sherbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit.

Me investimet e planifikuara në ndërrimin e shtrese se filtrave do te permisohet sasia e gjertanishme e prodhimit të ujit 80 l/sec, me këtë investim do te kemi mundësin e rritjes së kapacitetit të prodhimit në 140 l/sec , çka do nenkupton se sasia e prodhimit të ujit rritet për 60/sec. Ky sistemi furnizimit është me ramje të lirë , uljen e shpenzimeve të energjis elektrike se një pomp mund të del nga prodhimi si rezultat i shtimit të kapaciteteve prodhuese , si dhe permisohet kualiteti i ujit të prodhuar nga ky system.

Investimet në infrastrukturen e ujrave të zeza janë të vogla karshi investimeve të bëra neinfrastrukturen e ujit, por tani është domdsdoshmeri e kohes që ti qasemi trajtimit të ujit të pijes ku ne planifikim ton kemi parapar disa investime të cilat janë mëse te nevojshme në zgjerim dhe zavendësim rrjeti, ku i paraprin parapergaditjes së investimeve Kapitale për trajtimin e ujit të pijes .

Planifikimi i investimeve në perpunimin e ujrave të zeza është dhënë vetem si ide project duke u bazuar në fizibilitetin e bër nga KfË në vitin 2004 për qytetin e Prizrenit .

Investimet në permisimin e kualitetit të ujit si dhe në laboratorin për analiza të ujit do të na mundësojn që të kemi një kontrollë permanente të ujit , analizat e ujit do te bëhen për

çdo ditë dhe sipas nevojës, do të ngritet kualiteti i ujit nga 92% në 97% në kuader të standardeve për ujë të pijes .

Plani për mirëmbajtjen e rrjetit të ujit dhe kanalizimit –saijimet e defekteve mujore 125 në 130 (4% Rritje).

Plani i Detektimi i rrjetit të ujësjellësit; nga 120 raste të detektimit në 140 raste , por mvarsisht prej nevojës dhe kërkesave mund të rritet (14% Rritje).

Trajnimi i ekipeve për përdorimin e paisjeve për detektim.

Plani për evitimin e humbjeve teknike nga 45% në 40%, me investimet që do të realizohen nga mjetet vetanake, donacionet nga KfE, USAID-I dhe MEF.

3.1.1 Planifikimi i zgjerimit të shërbimit

Kompania në politiken zhvillimore ka në plan edhe zgjerimin e shërbimeve edhe në pjesët tjera të fshatrave të cilat janë jashtë menagjimit të Kompanisë.

Në bashkpunim me K.Kmunale me nënshkrimin e momerandumit të mirëkuptimit jemi akurduar që fshatrat të cilat janë të gatshme dhe plotësojnë kushtet teknike dhe ekonomiko-finansiare mund të kalojnë nën shërbimin e Kompanisë.

Në diasponojm stafin dhe mekanizmin për të bërë një shërbim cilësor dhe efektiv.

Planifikojmë gjatë vitit 2011 të kemi zgjerim të shërbimeve në proporcion me numrin e tanishëm të konsumatorve për (10 - 11)%

Njësia punuese Prizren:

Nr	Emir i fshatit	Numri i banorve	Numri i konsu.	Sistemi i furnizimi.
1	Velezhe	2000	400	Pompim
2	Shpenadi	1500	300	Pompim
3	Smaqi	1000	200	Pompim
4	Caparci	1500	300	Pompim
5	Trepetnica	800	160	Pompim
Gjithesëj		5900	1360	

Njësia punuese Suhareke:

Nr	Emir i fshatit	Numri i banorve	Numri i konsu.	Sistemi i furnizimi.
1	Ternje	1300	170	Pompim
2	Mushtishti	4500	600	Gravitet
3	Sallagrazhde	2500	220	Gravitet
Gjithesëj		8300	990	

Njësia punuese Malisheve:

Nr	Emir i fshatit	Numri i banorve	Numri i konsum.	Sistemi i furnizimi.
1	Gurbardhi	1660	168	Pompim
2	Turjaka	1663	167	Gravitet
3	Dragobil	1373	138	Gravitet
Gjithesëj		2696	473	

Njesia punuese Dragash:

Nr	Emir I fshatit	Numri I banorve	Numri i konsum.	Sistemi i furnizi.
1	Rrapqe e larte	1370	230	Gravitet

Gjithesej numri i konsumatorve.....3053 konsumator

3.1.2 Plani I investimeve kapitale

Plani i Investimeve eshte nje pjese e rendesishme e Planit te Biznesit, i cili i mundeson ujesjellesit te bejne permiresimin e sherbimeve te tyre per konsumatore dhe do ti inkurajoje konsumatoret ti paguajne faturat e tyre.

Plani i investimeve do te perbehet prej nje perzierje te projekteve, ku disa prej tyre do te jene pjese e financimit nga Kompania nga te ardhurat e tyre. Megjithate ekziston nje numer i projekteve te medha te cilat kerkojne financim te jashtem edhe vleresim te detajuar.

Qellimi i Planit te Investimeve eshte qe te siguroje se Kompania eshte duke bere planifikim te pershtatshem per mirembajtjen e rregullt dhe zhvillimin e infrastruktures se ujesjellesit.

Identifikimi i investimeve, me qellim te arritjes se ndryshimeve te standardeve te kualitetit apo sherbimeve shqyrtohet sipas vleresimit te gjendjes se aseteteve qe jane ne dispozicion me qellim te arritjes se gadishmerise teknike te pajimeve. Keto investime planifikohen te jene pjesë e grandeve nga KfE, USAID, MEF, Kuvendi Komunal si dhe nga mjetet vetanake të Kompanis.

Ne baze te analizes dhe gjendjes momentale qe kemi ne teren, ne kemi percaktuar prioritete e investimeve ne nivel te Kompanise-Njesive punuese.

Keto prioritete jane te domosdoshme ngase:

- permiresohet dukshem furnizimi me uje
- permiresohet cilesia e ujit
- zvogelohen humbjet teknike dhe komerciale
- shtohet numri i konsumatoreve te rinje
- zvogelohen shpenzimet operative te mirembajtjes
- rritet shtimi i sherbimeve te Kompanise
- evitohet mundesia e ndotjes se ujit te pijes nga ujerat e zeza

Ne ne planifikimin e investimeve kemi parare investime ne infrastrukturu dhe jo infrastruktur ky planifikim po qe se realizohet do te kemi nje furnizim me te mire ,si dhe evitimi i humbjeve teknike .

3.1.3 Infrastruktur e re

Investimet ne infrastrukturen e re ne rretin e ujesjellsit , vlera e investimeve per vitinn 2011 eshte planifikue 1.162.609 ,00€ nga Buxheti i Kompanis dhe Grantet , Buxheti

Shtetit , Fondet e Njesive Vendore ku jane te paraqitura edhe ne tabelen e planifikimit te investimeve Kapitale . Me realizimin e ketyre investimeve do te kemi permiresimin e kualitetit te ujit, shtimin e numrit te konsumatorve, uljen e shpenzimeve te energjise elektrike, zgjerimin e sherbimeve etj .

Ne kete planifikim eshte parapar edhe investime ne infrastrukturen e Re ne rrjetin e Kanalimit ,ku kemi ende pjese te qyteteve dhe Fshtrave ku nuk kan rrjet te kanalimit dhe derdhja e ujrave te zeza behet pa kurrfar kriteri - kontrole dhe si rrezultat i ketyre ujrave kemi ndotje te ujrave siperfaqsores , qfaqjen e epidemive etj.

Ne kuder te investimeve eshte parapar edhe trajtimi (perpunimi) i ujrave te cilet derdhen vend e pa vend ne pjese te Qyteteve dhe Fshtrave.Tani eshte momenti i fundit qe edhe ne te bejme planifikimin e trajtimit te ujrave te Zeza, eshte edhe kriter i Bashkesis Evropjane qe ujrata eZeza para se te derdhen ne lum te behet trajtimi paraprak i ujit .

Vlera e investimeve ne infrastrukturen e ujrave te Zeza per vitin **2011 = 10.066.000,00** nga Buxheti i Kompanis dhe Grantet , Buxheti Shtetit , Fondet e Njesive Vendore ku jane te paraqitura edhe ne tabelen e investimeve Kapitale .

Perpunimi i ujrave te zeza eshte i kushtueshen. Ne te ardhmen do te kemi ngritje te qmimit per perpunimin e ujrave te zeza (Kuader Profesionele , teknologji aplikative e tj).

3.1.4 Pertritje e infrastruktures (zevenendesimi i infrastructures)

Regjioni I Prizrenit ka nje rrjet te ndertuar ne periudha te ndryshme nga vitet e 60 si dhe nga materialet te ndryshme, Ne kemi bere planifikim e investimeve ne ndrrimin e rrjetit te ujesjellsit ne rruget ku mendojm se kemi humbje teknike, lidhje ilegale, si dhe presion te ulet.

Me realizimin e ketyre projekteve ne do te kemi permiresimin e furnizimit me uje, kulitetin e ujit te pijes, zvoglumin e humbjeve teknike te ujit, uljen e shpenzimeve operative, shtimin e numrit te konsumatorve .

Planifikimi i InvestimetKapitale ne pertritjen e infrastruktures e ujit per vitin **2011= 1.899.280,00 €** nga Buxheti i Kompanis dhe Grantet , Buxheti Shtetit , Fondet e Njesive Vendore ku jane te paraqitura edhe neTabelen e Planifikimit te investimeve Kapitale .

Gjatesia e rrjetit te planifikuar per nderrim ne raport me rrjetin e tersishem te ujesjellsit eshte 3%. Ku nenkupton se per te nderruar rrjetin e tersishem te ujesjellsit dhe per te pas nje rrjet funksional, kerkohet mjete te kosiderushme .

Investimet ne pertritje e infrastructures se Kanalimit jene parapar ne disa rruge ku kemi nevoj per investime se eshte rrjet i vjeter dhe tani nuk ploteson nevojat per rrugen egzistuese, si dhe investime per parapergaditje per ndarjen e ujrave te zeza dhe te shiut.

Vlera e investimeve ne pertritjen e rrjetit te Kanalimit per vitin **2011=141.000,00 €** nga Buxheti i Kompanis dhe Grantet , Buxheti Shtetit , Fondet e Njesive Vendore ku jane te paraqitura edhe neTabelen e investimeve Kapitale .

3.1.5 Investimet kapitale jo- Infrastruktural (zakonisht te gjitha ato asete te cilat jane mbi tokesore)


Planifikimi i Investimet Kapitale ne joinfrastruktur eshte i nevojshem duke pas parasysh kohen e ndertimit si dhe shkallen e amortizimit ,me keto investime nedo te kmi zvoglumin e shpenzimeve Elektrike ,rritjen e kapaciteteve prodhues te ujit ,ngritjen e

kualitetit te ujit , kontrolla e kualitetit te ujit permanent,ngritja e cilesis se punes dhe stafit etj.

Vlera e planifikomit te investimeve ne Jo infrastruktur per vitn **2011=587.247,00 €** nga Buxheti i Kompanis dhe Grantet , Buxheti Shtetit , Fondet e Njesive Vendore ku jane te paraqitura edhe ne Tabelen e investimeve Kapitale .

Planifikimi I investimeve kapitale eshte i pershkruar ne menyre detale per çdo project si dhe periudhen e realizimit pergjat viteve te planifikimit si dhe mjetet e planifikuara per realizim pergjat viteve **2011- 2014**

INVESTIMET ME MJETE VETANAKE PER 2011-2014				
<i>Investimet vetanake -UJI dhe Kanalizim</i>				
Nr.	Pershkrimi	Investimet e pergjithshme-UJI	Investimet e pergjithshme-KANALIZIM	TOTAL
1	Pertritja e infrastruktures	91,512.00	66,000.00	157,512.00
2	Zevendesimi I infrasëtruktures	507,189.00	0.00	507,189.00
3	Shpenzime Kapitale Jo infrastrukture	72,082.00	170,000.00	242,082.00
TOTAL		670,783.00	236,000.00	906,783.00



3.1.6 Objektivat kryesore nga sherbimi Teknik

Nje nder Objektivat kryesore te Departamentit Teknik permes Sektorit te Plan-Zhvillimit si dhe Kompanise si teresi eshte edhe angazhimi maksimal rreth verifikimit dhe menjanimit ne teresi te humbjeve teknike dhe komerciale duke ndermarre ne menyre reale veprimtarite si ne vijim:

- Percaktimin e Pilot Zonave ose Zonave demonstrative ne tere regjionin qe e mbulon kompania HRJ
- Verifikimi dhe rifreskimi i te dhenave per te gjitha konsumatoret permes ekipeve operuese ne teren.
- Ne muajin Nentor kemi percaktuar dhe definuar tri Pilot Zona apo zona demonstrative ne Prizren, Malisheve dhe Dragash, per vendosjen e Ujemateseve Zonal me te vetmin qellim per te matur sasine e sakte te hurjes se Ujit te pijes ne zone dhe verifikimin e llojit te humbjeve dhe sasise se humbjeve te ujit ne m3. Ne rastin e percaktimit dhe definimit te Pilot Zonave kemi grumbulluar te gjitha informacionet e duhura Teknike Juridike dhe financiare me qellim te funksionimit sa me te mire per demostrimin e ketij projekti.
- Ne te ardhmen planifikojme definimin e sakte te Zonave per tere regjionin qe Kompania jone e mbulon me furnizim te Ujit te pijes, duke u bazuar ne suksesin e Zonave Demonstrative te meherhshme.
- Per realizimin e ketij Projekti jemi percaktuar ne mundesine e investimeve nga donatoret Potencial si: KFW, USAID, MEF, Investime Vetanake, Kuvendi Komunal, etj.

Sektori I Plan-Zhvillimit perms nensektorit te BlockMapping-ut , Kontrolles dhe Bazhdarimit eshte e fokusuar ne keto detyra kryesore si:

- Blombimin e ujematesve
- Zavendsimi I ujemateseve
- Riparimi I rrjedhjeve
- Parandalimi të rrjedhjeve ilegale
- Pastrimi I pusetave
- Nënshkrimi I kontratave
- Regjistrimi I konsumatorve të rinje

Ne te ardhmen planifikojme qe perms formimit te grupeve shtese ne teren te shpejtojme ecurin e verifikimit dhe rifreshimit te konsumatoreve ne pergjithesi.

Te gjitha keto angazhime do te konsistonin ne matjen e sakte te prodhimit te ujit te pijes, ne menjanimin e humbjeve teknike dhe komerciale qe rrjedhimisht do te ndikonin ne rritjen e performances se kompanise si teresi me te vetmin qellim furnizimin sa me te mire te te gjitha konsumatoreve me uje te pijes.

3.1.7 Planifikimi i humbjeve te ujit 2011-2014

Shërbimi Teknik në bashkpunim me të gjitha shërbimet e tjera të kompanisë parashikon që deri në vitin 2014 të zvoglojë humbjet e ujit deri në 14%. Këto synime mendojmë se janë reale dhe bazohen në këto faktorë;


1. Zvoglimi i humbjeve teknike

- Zavendësimi i rrjetit të vjetruar
- Detektimi i rrjedhjeve të ujit
- Evidentimi dhe sanimi i rrjedhjeve nëntoksore dhe mbitoksore
- Etj.

2. Zvoglimi i humbjeve komerciale

- Evidentimi dhe eliminimi i lidhjeve të paligjshme
- Instalimi apo zavendësimi i ujëmatësave
- Faturimi sipas konsumit real (eliminimi i faturimit paushall)
- Etj.

Planifikimi sipas viteve	2010	2011	2012	2013	2014
Uje i pafaturuar-si perqindje %	59%	56%	52%	47%	45%



3.2.1 Plani operacional

Programet operacionale teknike ne rrjetin e ujesjellesit dhe kanalizimit, stabilimentet Elektro Mekanike, jo infrastruktur ne vitin 2011 do te kemi;

Investimet ne sistemin e filtrimit,

Kualitet te ujit dhe shtimin e prodhimit, ne sistemin e filtrimit nga 80l/sec-140 l/sec, sasia e ujit rritet per 60 l/sec.

Ky system eshte me ramjet e lire, do te kemi ulje te shpenzimeve te energjis elektrike, nje pomp mund te dal nga perdorimi si rezultat i shtimit te prodhimit.

Investimet e planifikuara per kualitetin e ujit (Laboratorin) , na mundesojn qe te kemi nen kontrole permanente analizat e ujit –kualitetin e ujit,Perqindja e analizave do te permisohet nga 92% ne 96% (4 % rritje) ne kuader te standarteve .

Investimet ne infrastrukturen e ujrave te zeza jane te vogla karshi investimeve te bera ne rrjetin e ujesjellesit. Planifikimi i investimeve ne perpunimin e ujrave te zeza eshte dhene vetem si ide project duke u bazue ne fizibilitetin e ujrave te zeza per qytetin e Prizrenit te bere nga KfE .

Plani per mirmbajtjen e rrjetit te ujesjellesit dhe kanalizimit –sajimi i defekteve mujore nga 125-130 (4% rritje).

Plani i detektimit te rrjedhjeve ne rrjetein e ujesjellesit nga 120 rastë te detektimit ne 140 raste ,por mvarsisht nga rastet dhe kerkest mund te rritet 14% .

Trajnimi i ekipit per perdorimin e e paisjeve për detektim dhe matjen e prodhimit të ujit.

4.Plani i menagjimit te aseteve

Duke pasur parasysh gjendjen e tanishme të aseteve, mendojmë se nuk ka qenë një planifikim i mirëfilltë në menagjimin e aseteve dhe gjendja e aseteve është në një gjendje jo të kënaqshme. Asetet që tani i kemi në shfrytëzim janë sipas periudhave të ndertimit para lufte dhe pas lufte .

Duke parë gjendjen e aseteve pas lufte janë bërë investime në Rehabilitimin dhe ndërtimin e Rezervareve të rinj rrjetet e ujësjes dhe kanalizimeve , fazineri, ujëmatësa të profileve të ndryshme si dhe në mjetet e punës, ndihma me makineri në shtimin e sasisë së ujit ,në kualitetin e ujit.

Të gjitha keto ndihma ,investime kanë ndikuar në përmirësimin e gjendjes së aseteve dhe performansës se Kompanive .

Tani kemi një gjendje më të mirë, por ka ende për të bërë .

Duke pasur parasysh gjendjen e aseteve dhe analizave të bëra nga të dhënat e përditshme kemi percaktuar objektivat dhe prioritetet e projekteve.

Objektivat tona për të pasur një menagjim më të mirë dhe kontrollë mbi asete janë;

- Zëvendësimi i rrjetave të vjetëruara të ujit dhe kanalizimit 5% për çdo vit
- Mirëmbajtja e rrjetit të ujit dhe kanalizimit
- Formimi i grupit të veçantë për detektimin e humbjeve
- Zbatuesmeri e procedurave të punës ,në perpikëri nga përgjegjësit e thirrur
- Plotësimi i rregullatives së brendshme –adresimi më i mirë dhe më i saktë i përgjegjësive

- Planifikimi i resurseve njerëzore –trajnimet e nevojshme
- Shfrytëzimi i të gjitha veprave menaxhuese .
- Realizimi i projekteve sipas dinamikës së dhënë .
- Furnizimi me pajisje më të justifikueshme për detektimin e humbjeve dhe matjen e prodhimit të ujit.

5. Plani financiar

Një ndër objektivat kryesore e kompanisë për vitet 2011 - 2014 është rritja e të hyrave, respektivisht rritja e arketimit. Kompania është e orientuar që të jetë financiarisht e vetëqëndrueshme dhe e aftë ti kryej të gjitha shërbimet e domosdoshme.


Në këtë drejtim janë paraparë masa konkrete të cilat do të rezultojnë në rritjen e inkasimit;

- Përmirësimi i shërbimeve ndaj konsumatorëve
- Riorganizimi i shërbimit të inkasimit
- Trajnimi i stafit , me qëllim të përmirësimit të sjelljeve dhe kontakteve me konsumatorë
- Informimi i drejtë dhe me kohë i konsumatorëve
- Shqyrtimi i drejtë dhe në afat sa më të shpejtë i të gjitha ankesave dhe kërkesave të konsumatorëve
- Leximi i rregullt dhe i saktë i ujëmatësve
- Faturimi sipas shpenzimit (Eliminimi i faturimit paushall)
- Kontaktet me konsumatorë me shumë të lartë të borxheve ndaj kompanisë (mundësia e nënshkrimit të kontratave për shlyerjen e borxheve me këste)
- Marrja e masave ligjore sipas Zyrës Rregullative (procedurat e shkyçjes)
- Forcimi i ekipeve të kontrolles dhe ekipeve për shkyçje
- Zgjidhja e rasteve sociale në bashkëpunim me institucionet tjera relevante

Kompania do të angazhohet dhe shpreson që gjatë vitit 2011 të inkasojë edhe borxhet e ndërmarrjeve të privatizuara. Borxhi i kompanive deri ne privatizim arrin shumë prej **318.672,68 Euro**. Mjetet e realizuara nga kjo kategori do të shfrytëzohen në realizimin e investimeve kapitale të kompanisë.


Planifikimi I Faturimit – uji 2011-2014

Planifikimi 2011-2014	2010	2011	2012	2013	2014
Faturimi total - uji	2,591,000	3,147,490	3,291,170	3,315,640	3,334,010



Planifikimi I Faturimit – kanalizimi 2011-2014

Planifikimi 2011-2014	2010	2011	2012	2013	2014
Faturimi total - Knlz	283,000	368,230	627,420	657,190	704,570




Masat e planifikuara per arritjen e objektivave te Kompanise

Me qëllim të përmirësimit të gjendjes financiare të Kompanisë janë planifikuar masa konkrete në përmirësimin e gjendjes aktuale:

- Përmirësimi i leximit të saktë të konsumit të ujit të pijes,
 - Marrja e masave ndëshkuese ndaj mos leximit apo leximit qëllimisht të gabuar.
 - Zvogëlimi i faturimit paushall.
 - Vendosja e ujëmatësve tek konsumatorët pa ujëmatës apo ndërrimi i ujëmatësve jo funksional.
 - Zvogëlimi i keqpërdorimeve
 - Forcimi i ekipës së kontrollës
 - Marrja e masave ligjore ndaj kyçjeve të paligjshme.
 - Përmirësimi i inkasimit.
 - Përmirësimi i raporteve Konsumatorë-Kompani
-
- Përgatitja dhe realizimi i fushatave të vetëdijesimit të popullatës duke bashkëpunuar edhe me institucionet tjera (Kuvendin Komunal, SHPK-ne, Gjykatat dhe Mediat).


Planifiki I arkëtimit- uji 2010-2014

Planifikimi 2011-2014	2010	2011	2012	2013	2014
Arkëtimi total - uji	1,786,000	2,333,440	2,632,630	2,678,520	2,713,090



Planifiki I arkëtimit- Kanalizim 2010-2014

Planifikimi 2011-2014	2010	2011	2012	2013	2014
Arkëtimi total - Knlz	195,000	273,650	331,770	372,870	440,940



Analiza e shpenzimeve

Sa i perket analizes se shpenzimeve Kompania "Hidroregjioni Jugor" SH.A do te financoje ne menyre kualitative shpenzimet operative, te mirembajtjes dhe do te ndaje mjete te domosdoshme per ripertirjen e te gjitha aseteteve.

Te gjitha shpenzimet, edhe ato qe i perkasin stafit do te orientohen ne funksionimin normal te te gjitha segmenteve te punes ne ujesjelles dhe prioritet kryesor eshte arritja e objektivave qe jane percaktuar ne pjesen hyrese te ketij Plani te Biznesit.

Kursimi ose ulja e kostos së energjisë elektrike gjate vitit 2011 planifikohet të arritet me realizimin e investimeve të parapara nga Donatori I Bankes Gjermane KfW.


Një aktivitet tjetër në këtë drejtim është se Kompania do të perçendrohet në kursimin e energjise elektrike ne disa stacione te pompimit, ku gjate oreve te mbremjes do te ç'kyqen prej punes 40% te pompave.

Kompania do të angazhohet qe te zvoglojë edhe shpenzime tjera, aty ku është e mundur ne menyre qe me te hyrat e arketuara t'i mbulojë shpenzimet e rregullta operative; shpenzimet e kompenzimit për punën jashtë orarit, shpenzimet për palët e treta etj.

Duke marrë parasysh se kompania planifikon zgjerimin e shërbimeve kemi një rritje të shpenzimeve të përgjithshme prej 136.200 Euro në krahasim me vitin 2010.

Planifiki i shpenzimeve 2010-2014

Planifikimi 2011-2014	2010	2011	2012	2013	2014
Shpenzimet	2,029,000	2,165,200	2,308,070	2,389,700	2,476,060



6. Plani i zhvillimit te stafit

Raportet midis stafit do të përcaktohen në bazë të Rregullores së organizimit të brendshëm të Ujësjetës, ndërsa kryerja e detyrave të punës do të bëhet në varshmëri të përshkrimit detal të secilit vend të punës veç e veç. Në bazë të këtij përshkrimi do të përcaktohen edhe kushtet minimale (përgatitja profesionale, përvoja e kaluar në punë të ngjashme apo të përafërt, shkathtësitë tjera të veçanta për lidhjen e marrëdhënies së punës, shkalla e përgjegjësisë të punëtorëve, niveli i pagesës si dhe hierarkia e dhënjes së përgjegjësisë).

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ndaj konsumatorëve, respektivisht mirmbajtjes së rrjetit kompania ka paraparë që të rrisë numrin e punëtorëve për vitin 2011 për pesë (nga 223 në 228). Këta punëtorë do të jenë të angazhuar kryesisht në shërbimin e inkasimit dhe kontrollës në zonat e reja të sh

Stafi i punësuar do të jete heterogjen:

- Nga aspekti i përgatitjes profesionale;
- Nga aspekti i shkathtësisë dhe racionalitetit në punë;

- Nga aspekti i përfaqesimit nacional;
- Nga aspekti i përfaqesimit gjinor;
- Nga aspekti i përfaqesimit fetar;
- Nga aspekti social etj.

6.1.1 Trajnimi i stafit

Metodat e reja të punës në drejtim të realizimit të strategjive për sukses të kompanisë ka bërë që kompania të planifikojë edhe zhvillimin e stafit përmes organizimit të trajnimit dhe specializimit të tyre sidomos në sektoret ku synohet që të arrihet sukses në rritjen e arkëtimit, zvogëlimin të humbjeve të ujit si dhe përmirësimin të kualitetit të ujit, me metoda dhe strategji të përparuara të praktikave evropiane.

Perveç këtyre trajnimeve do të ketë trajnime edhe në këto lëmi si: aftësimi i stafit në përdorimin e softverit të ri në lëminë e kontabilitetit, trajnimi i udhëheqësve të departamenteve në lëminë e menaxhimit të sektoreve përkatëse, trajnimi i punëtorëve të administratës në përfundimin e njohurive në përdorimin e programeve të ndryshme.

P.S: Bashkëgjatur gjendet edhe forma tabelare për të gjitha shërbimet.

6.1.2 Struktura organizative

Në bashkëpunim me USAID-in kompania ka përgatitur një organogram të ri për kompaninë.

Ndryshimet e propozuara kanë pasur për qëllim ndarjen më të mirë të përgjegjësive dhe menjanimin eventuale të interesit në mes të shërbimeve.



K.R.U. „Hidroregjioni Jugor” Sh.A

RR. WESLEY CLARL P.N.

20000 PRIZREN

Kosovë